



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:062758

Datë: 11.10.2024

Numri i dokumentit: 06289018

KF.nr.417/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar administrativ, të paditësit “Beltec” Sh.P.K, me numër unik identifikues 811184308, dhe me seli në fshatin Cërrnicë, Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Granit Vokshi, avokat nga Shoqëria e Avokatëve “Koci & Vokshi”, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti 11,771.92 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 04.10.2024, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Granit Vokshi avokat, dhe në mungesë të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Beltec” Sh.P.K, me numër unik identifikues 811184308 dhe seli në fshatin Cërrnicë, Gjilan.
- II. ANULOHET vendimi nr.15/2021 i datës 23.02.2021 i Divizionit të Ankesave nga Administrata Tatimore e Kosovës.
- III. OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit, “Beltec” Sh.P.K, me NUI 811184308 ta liroj nga obligimet tatimore të përcaktuara më tepër, në pjesën që i referohet TVSH-së për vitin 2016 dhe atë në shumën prej 11,771.92 € (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një euro e nëntëdhjetë e dy cent).
- IV. Obligohet e paditura që Paditësit Beltec Sh.P.K. t’ia kthej shumën e përgjithshme prej 2,942.79 € (dymijë e nëntëqind e dyzet e dy euro e shtatëdhjetë e nëntë cent) të paguar në emër të ndëshkimeve me kamatë ligjore në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave

të Republikës së Kosovës në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së vendimit të nxjerrë nga e Paditura e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi.

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes padisë së paraqitur në Gjykatë, ka iniciuar konfliktin administrativ ndaj vendimit nr. 15/2021 të datës 23.02.2021, të Divizionit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Si në padi, ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor dhe fjalën përfundimtare, ai ka theksuar se vendimi i ATK-së përmban të meta formale dhe është në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, pasi nuk i adreson arsyet për të cilat nuk janë marrë në konsideratë pretendimet e tij. Paditësi pohon se ATK ka llogaritur TVSH-në për mungesat materiale duke vendosur çmimin prej 8,241.17 Euro për kilogram të lllamarinës së zinkuar, çka e ka rritur në mënyrë të padrejtë detyrimin e tij për tatim shtesë, duke përfshirë edhe një ndëshkim për rritje të kreditimit prej 25% (shumën prej 3,043.19 Euro). Shton se kalkulimi i çmimit mesatar të shitjes, i bazuar në çmimin e eksporteve për të përfshirë edhe mallrat e shitura për eksport, është jo i saktë dhe se kjo llogaritje e gabuar ka rritur detyrimin tatimor shtesë për TVSH-në. Më tej shton se Aktgjykimi A.nr.930/17 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ, e ka anuluar vendimin e ATK-së dhe ka udhëzuar që të ofrohen prova të sakta që dokumentojnë faktin e eksportimit të materialeve. Megjithatë, sipas paditësit, ATK ka marrë përsëri të njëjtin vendim, edhe pse ka konfirmuar se faturat ishin regjistruar gjithashtu te subjekti "Fejza." Më tej thekson se llogaritja materiale e stoqeve është bërë në shkurt 2017, jo në dhjetor 2016, duke bërë të pakuptimtë pretendimin e mungesës së stoqeve për periudhën e fundit të vitit 2016, periudhë kur nuk ka pasur kontroll të stoqeve. Ai gjithashtu shpjegon se në vitin 2017 paditësi ka qenë një biznes i ri që operonte në një industri specifike, ku kërkohej trajnim i veçantë për punëtorët. Për shkak të mungesës së punëtorëve të trajnuar për prodhimin e lllamarinës së zinkuar, kanë ndodhur gabime të shumta në prodhim, të cilat kanë rezultuar në produkte të papërshtatshme për eksport, duke u shitur vetëm si mbetje për lirim të hapësirës së prodhimit me një çmim minimal prej 0.10 Euro për kilogram te kompania "Fejza." Gjithashtu thekson se aplikimi i çmimit mesatar të shitjes bazuar në mallrat e shitura për eksport për mallrat e mbetura në stok është në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit për TVSH-në, i cili

kërkon që çmimi të reflektojë vlerën e hapur të tregut për tregun e Kosovës. Gjithashtu thekson se, nëse edhe nuk i besohet faturave të prezantuara nga tatimpaguesi, ATK-ja duhet të kishte bërë një vlerësim të bazuar në çmimet e tregut të brendshëm. Ndërhyrja e ATK-së, duke përdorur çmimin e eksportit për të shumëzuar sasinë e stokut të mbetur, është pa mbështetje ligjore dhe është në kundërshtim me parimet e ekonomisë së tregut, pasi ndërmarrja nuk ka pozitë monopolistike në treg. Ekspertiza financiare e ekspertit të pavarur, Lekë Musa, konfirmon pretendimet e paditësit duke konstatuar se detyrimi për TVSH në vlerë prej 11,771.92 Euro është e padrejtë dhe paditësi duhet të lirohet nga kjo ngarkesë e pabazuar. Gjithashtu, ekspertiza financiare ka vërtetuar se paditësi është obliguar të paguajë një ndëshkim në vlerë prej 3,043.19 Euro, ndërkohë që ndëshkimet e aplikueshme do të ishin vetëm 100.40 Euro. Në këtë aspekt, paditësi kërkon kthimin e diferencës në mes të shumës së paguar dhe asaj që duhet paguar realisht duke precizuar kështu kërkesëpadinë me propozim që të aprovohet në tërësi e themeltë Padia e Paditësit të anulohet vendimi nr. 15/2021 i datës 23.02.2021 i Divizionit të Ankesave nga Administrata Tatimore e Kosovës, obligohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësin Beltec Sh.P.K., me NUI 811184308 ta liroj nga obligimet tatimore të përcaktuara më tepër, në pjesën që i referohet TVSH-së për vitin 2016 dhe atë në shumë prej 11, 771.92 EUR; Obligohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës që Paditësit Beltec Sh.P.K.; t'ia kthej shumën e përgjithshme prej 2942,79 EUR të paguara në emër të ndëshkimeve, me kamatë ligjore në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave të Republikës së Kosovës në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së vendimit të nxjerrë nga e Paditura e deri në pagesën definitive.

Në përgjigjen ndaj padisë, e paditura deklaron se vendimi nr. 15/2021 është në përputhje me legjislacionin tatimor dhe e konteston padinë e paditësit si të pabazuar. E paditura tutje thekson se, për të përmbushur detyrimet nga Aktgjykimi A.nr.930/17, ajo ka realizuar një vizitë te subjekti "Fejza-A," nga e cila ka rezultuar se, përveç dy kuponëve jo-fiskalë të vitit 2017, nuk janë evidentuar blerje të tjera nga paditësi. E paditura konsideron të drejtë vendimin kontestues dhe në mungesë të provave nga paditësi vlerëson se çmimi mesatar i llogaritur është i vlefshëm, duke mbështetur çmimin e eksportit.

Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar - administrativ konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palës së paditur ngase e paditur e ka pranuar ftesën për këtë seancë, ndërsa me

parashtesën e datës 27.09.2024 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seancë duke kërkuar nga gjykata që të veproj në pajtim me nenin 38 par 5 të LKA-së. Po ashtu me këtë parashtesë e ka njoftuar gjykatën se e kundërshton ekspertizës e ekspertit financiar Lekë Musa. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet padi/ankesa e paditësit në tërësi si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi nr.15/2021 i datës 23.02.2021.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik ka administruar provat relevante dhe atë: Kërkesë për rimbursim/ kthim e datës 11.01.2017, Raport i kontrollit i datës 08.02.2017, Ankesë në ATK e datës 21.03.2017, Aktgjykim A.nr.930/17 i datës 13.10.2020, Vendim nr.15/2021 i datës 23.02.2021, Dy fatura me nr. K0002 Faturë K0003, K0001, Katër kuponë fiskal, Email i datës 17.03.2017, Përgjigje në padi e datës 03.12.2021, Formë për vizita përmbushëse e datës 11.02.2021, Libri i blerjes, Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve tjera e datës 12.01.2021, Ekspertizë financiare Korrik 2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë Kontest Tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë Kontest Tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga Raporti i Kontrollit nr. 2641 dt. 08.02.2017, i Administratës Tatimore të Kosovës, deklarimeve në ankesë, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se paditësi pas parashtrimit të kërkesës për rimbursim të mjeteve, është përzgjedhur nga Administrata Tatimore në Kosovë si rast për kontroll, me ç'rast edhe është lëshuar raporti i kontrollit nr. 2641 dt. 08.02.2017. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, me datë 21.03.2017, ka ushtruar ankesë në Departamentin e Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, e për të cilën ankesë, ATK me datë 26.04.2017, ka nxjerr Aktvendimin nr. 110, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektin në procedurë, e kundër të cilit, paditësi me padinë e datës 31.05.2017, ka iniciuar konfliktin administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë,

Departamenti Administrativ-Divizioni Fiskal e cila me vendimin A.nr.930/17 ka aprovuar kërkesëpadinë, duke anuluar kështu aktvendimin nr.110 të datës 26.04.2017 të të paditurës dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje. E paditura në rivendosje ka nxjerr vendimin nr.15/2021 të datës 23.02.2021 e ndaj të cilit paditësi ka iniciuar këtë konflikt administrativ.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, gjykata ka konstatuar se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës – Departamenti i Ankesave, në rivendosje serish ka refuzuar si të pabazuar ankesën e këtua paditësit, me arsyetim se ka pranuar përgjigje sipas Listë Distribuimi - Kërkesës për Informata shtesë nga Drejtoria Rajonale e ATK-së Gjilan. Sipas Aktivitetit Formë për Vizitat Përmbushëse (AU005) datë 11.02.2021 e realizuar tek subjekti Fejza -A me numër fiskal: 600680343, qëllimi i së cilës vizitë ka qenë verifikimi i transaksioneve të shitblerjes në mes të bizneseve " Fejza -A' me NRF: 600680343 dhe " Beltec " ShPK me NRF: 601145792 është konstatuar se biznesi " Fejza -A " ka prezantuar kopjen e dy kuponëve jo fiskal si dhe kopjen e librit të blerjes në të cilin janë të evidentuar këta dy kuponë. Kuponët me nr. 1101172 dhe 1101173 të datës 03/02/2017, ku malli i blerë është mbeturinë llamarinë (me përshkrim hekur, mbeturinë llamarinë sasia $1040\text{kg} \times 0.10=100.40\text{€}$ si dhe $360\text{kg} \times 0.10=36.00\text{€}$). Tatimpaguesi "Fejza-A" nuk ka blerje tjetër të evidentuar në librin e blerjes nga tatimpaguesi " Beltec " ShPK (dëshmi: AU00S, datë 11/02/2021, dy kuponët jo fiskal si dhe libri i blerjes). Mirëpo Divizioni i Ankesave bazuar se vlerësimi i kontrollit është bërë deri në periudhën 12/2016 ku nga analiza materiale e llamarinës se zinkuar ka rezultuar edhe mungesa e konstatuar në sasi prej 8,206.00kg, vërteton se kuponët jo fiskal të vërtetuar tek subjekt Fejza-A nuk do merren parasysh pasi që të njëjtit i takojnë periudhës 02/2017 periudhë e cila nuk ka qenë objekt kontrolli dhe nuk ka ndikuar në mungesën e konstatuar me kontroll. Sa i përket rekomandimeve të Gjykatës sipas Aktgjykimit A.nr.930/2017 date 13/10/2020 që në përcaktimin e çmimit për mungesën e konstatuar të merren parasysh çmimet e tregut të brendshëm gjegjësisht dokumentacioni valid prezantuar nga tatimpaguesi që dëshmon për çmimin e shitur (kuponët tatimor dhe faturat e shitjeve vendore) e paditura ka arsyetuar se bazuar në verifikimet e bëra nga Drejtoria Rajonale Gjilan sa i përket validitetit të kuponëve tatimor dhe faturave vlerëson se për të njëjtat është konstatuar se nuk ekzistojnë transaksionet e tilla në përjashtim të dy kuponëve jo tatimor dhe atë për mallra të shitur si mbeturinë, andaj në mungesë të argumentimit nga ana e tatimpaguesit për shitje vendore sa i përket mallit të njëjtë, me konstatim se tatimpaguesi mbetet obligues sipas Njoftim vlerësimeve për qarkullim shtesë të lëshuara nga Drejtoria Rajonale Gjilan.

Gjykata vlerëson të pabazuar arsyetimin e të paditurës se çmimi mesatar është nxjerrë nga dokumentacioni i paraqitur nga paditësi, dhe konstatoi se ka shitur llamarinë të zinkuar brenda shtetit, tek subjekti Fejza-A. Në këtë pikë, e paditura fare nuk i është përgjigjur obligimeve të dala nga aktgjykimi paraprak, kur ka qenë e obliguar të vërtetoj nëse ka pasur dëshmi për eksportimin e mallit në fjalë.

E paditura në përgjigje në padi ka ofruar si provë formën për vizitat përmbushëse të incizuar tek subjekti Fejza-A të cilën e mori për bazë në rivendosje, e sipas të cilës konstatohet se faturat e kontrolluar tek subjekti Fejza janë të datës 2017 dhe libri është i datës 2017, megjithatë gjykata vlerëson se kjo formë e vizitës nuk është realizua në plotni nga e paditura ashtu siç ka qenë e udhëzuar nga Gjykata me Aktgjykimin A.nr.930/17 ku taksativisht janë përshkruar obligimet për të paditurën që në rivendosje“ të *deklarohet lidhur me provat e administruara përkatësisht kuponët tatimor dhe faturat e shitjes së mallit, e-maillet e datës 06.02.2017 dhe 07.02.2017, dhe të bëjë edhe vizitë tek subjekti “Fejza-A” – Gjilan, për të verifikuar në regjistrat dhe librat e këtij subjekti, kuponët dhe faturat e lartcekura, si dhe evidentimin e mallit si blerje eventuale nga paditësi. Në arsyetimin e vendimit kontestues shihet se e paditura nuk ka shqyrtuar drejtë pretendimet e paditësit për të konstatuar se kuponët tatimor, dhe faturat shitëse, të përcjell përmes emaileve tek e paditura, pra përse nuk janë marr për bazë dhe nuk i kane pranuar si valide”* e njëjta nuk ka verifikuar tek subjekti librin e blerjes së vitit 2016.

Ndonëse e paditura ka realizuar vizitë te subjekti Fejza-A, Gjykata vlerëson se ajo nuk ka verifikuar librin e blerjes së vitit 2016. Nga raporti i vizitës nuk është e qartë nëse subjektit Fejza-A i janë ofruar për shikim faturat e vitit 2016, aty vetëm konstatohet se “është vizituar dhe na ka ofruar kopjet e dy kuponëve jo-fiskalë, si dhe kopjen e librit të blerjes ku janë të evidentuar këta dy kuponë.”, ndërsa libri i ofruar është i vitit 2017. E paditura ka dështuar të provojë nëse faturat që pala i ka bashkangjitur, të cilat vërtetojnë shitjen e sasisë prej 6,434 kg dhe 1,772 kg, janë verifikuar te subjekti Fejza-A. Në vend të kësaj, e paditura është mjaftuar me deklaratën se subjekti Fejza-A i ka ofruar këto informacione, të cilat rezultojnë të jenë vetëm për vitin 2017.

Gjykata në këtë konflikt tregtar administrativ, ka aprovuar propozimin e paditësit për nxjerrjen e provës përmes ekspertizës financiare lidhur me përcaktimin e shumës së përgjithshëm të TVSH-së të kredituar që duhet zbritur si rezultat i shitjes së sasisë prej 6,434 kg tek subjekti

Fejza-A Shpk, për përcaktimin e çmimit të shitjes për sasinë prej 1.772 kg sipas vlerës së hapur të tregut si dhe të përcaktimin e efekti tatimor.

Me ekspertizën financiare është dhënë mendimi se TVSH-ja e llogaritur duhet të jetë 401.61 euro e jo 12,172.76 euro siç është llogaritur fillimisht nga e paditura e që gjithsej efekti tatimor është 11,771.92 duro dhe se për shkak të zvogëlimit të TVSH-ës duhet të rillogaritet – zvogëlohet edhe ndëshkimi i cili e përfaqëson 25 % të TVSH-së, respektivisht ndëshkimi i përcaktuar nga ATK në shumën prej 3,043.19 euro dhe duhet të llogaritet proporcionalisht me vlerën e TVSH-së e që i bije 100.40 euro.

E paditura përmes parashtresës së datës 27.09.2024 e ka kundërshtuar ekspertizën financiare me arsyetim se paditësi nuk ka ofruar dëshmi që e paditura të vepronte ndryshe e po ashtu ka theksuar se në mënyrë të pabazuar eksperti është thirr se materiali është mbeturinë pa i marrë parasysh rrethanat dhe dokumentacionin kontabël në bazë të së cilës ka vendosur meritorisht e paditura.

Gjykata në bazë të gjendjes faktike të konstatuar më lartë, ballafaqimit të provave në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të vendimit kontestues, vlerësoi se organi i paditur ATK ka nxjerr konkluzion jo të drejt në pikëpamje të gjendjes faktike edhe atë lidhur me mosnjohjen e faturave të ofruar nga paditësi, respektivisht me konstatimin se ka mungesë stoku të padëshmuar si dhe llogaritjen e TVSH-së sipas çmimit shitës sipas eksporteve, duke mos vërtetuar drejtë gjendjen faktike nëse malli i munguar edhe është eksportuar.

Shuma e tatueshme për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve është e rregulluar me nenin 24 të Ligjit Ligji nr. 03/L- 146 për tatimin mbi vlerën e shtuar, ku në paragrafin 2 përcaktohet se : *Shuma e tatueshme për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve 1. Rregulla e përgjithshme: 1.1. në lidhje me furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, ndryshe nga ajo që është referuar në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, shuma e tatueshme duhet të përfshijë çdo gjë që përbën konsideratën e marrë ose që do të merret nga furnizuesi, në kthim për furnizimin nga konsumatori apo pala e tretë, duke përfshirë këtu subvencionet e lidhura direkt me çmimin e furnizimit; 1.2. nëse furnizimi është për konsideratë në para, vlera e tij duhet të merret si shuma*

e barabartë me konsideratë; 1.3. nëse furnizimi bëhet për konsideratë që nuk përbëhet nga paratë, ose që nuk përbëhet plotësisht nga paratë, vlera e tij duhet të merret sipas vlerës së hapur të tregut për furnizimin. 2. Për nevoja të këtij Ligji “vlera e hapur e tregut” nënkupton shumën e plotë që duhet ta paguaj konsumatori në shkallën e njëjtë të tregut në të cilin ndodh furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, nën kushtet e konkurrencës së barabartë, për furnizuesin nën mbizotërimin e tregut brenda Kosovës ku është bërë furnizimi, në mënyrë që të marr mallrat ose shërbimet në fjalë në atë moment. 3. Kur nuk mund të sigurohet krahasimi për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, “vlera e hapur e tregut” nënkupton si në vijim: 3.1. në lidhje me mallrat, një shumë që nuk është më e vogël se çmimi i blerjes së mallrave ose të mallrave të ngjashme, ose në mungesë të çmimit të blerjes, çmimi i kostos i përcaktuar në kohën e furnizimit; 3.2. në lidhje me shërbimet, një shumë që nuk është më e vogël se kostoja e plotë e personit të tatueshëm që e ofron atë shërbim.

Nisur nga të elaboruarat më lart, gjykata vlerëson se e paditura nuk ka vepruar në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura kur ka marr për bazë çmimet e shitjes së eksportit dhe të njëjtat i ka aplikuar si shitje e produkteve nga ana e ndërmarrjes për materialin i cili nuk është gjendur në stok.

Gjykata vlerëson se e paditura është dashtë të merr për bazë vlerën e hapur të tregut, përshtatshmërisht siç edhe ka vepruar eksperti në ekspertizën financiare kur për llogaritje të çmimit shitës sipas vlerës së hapur të tregut ka hulumtuar dhe ka marr ofertat të tregut.

Gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore. Prandaj, Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 43, par 3 dhe 46 par. 3 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative e miratoj kërkesëpadinë e paditësit, anuloi vendimin kontestues dhe e detyroj të paditurën Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit, të ia kthej shumën 11,771.92 euro dhe shumën e përgjithshme prej 2,942.79 euro, me kamatë ligjore në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave të Republikës së Kosovës në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së vendimit të nxjerr nga e paditura e deri në pagesën definitive.

Me nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L222 përcaktohet se: *“Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”*, ndërsa me nenin 7 par 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 përcaktohet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Nga dispozitat ligjore të lartcekura, Gjykata konsideron se barra e provës bie mbi palët ndërgjyqëse. E që rrjedhimisht e paditura nuk ka dëshmuar se malli të jetë eksportuar.

Ligji Nr. 03/L-202, për Konfliktet Administrative, Neni 46, paragrafi 1. *“Gjykata vendos për konfliktin administrativ me aktgjykim”*, paragrafi 2. *“Me aktgjykim, padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar”*. Paragrafi 3. *“Nëse padia aprovohet, gjykata anulon aktin administrativ të kontestuar”*, paragrafi 4. *“Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”*, dhe paragrafi 5. *“Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendos edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore”*.

Vendimi mbi kamatë në shumën e obliguar si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori duke aplikuar dispozitën e nenit 82 par.4 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku është paraparë se *“Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t'i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”*.

Gjykata i pati parasysh edhe deklaratimet e të paditurës të dhëna në përgjigjen në padi dhe në kundërshtimin e ekspertizës, mirëpo gjeti se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të

kësaj çështje juridike administrative. Kjo për faktin se paditësi pretendimet e veta siç u vlerësua edhe më lartë i ka të bazuara në fakte, të cilat i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore për tu njohur si të tilla, ndërsa pretendimi i të paditurës se eksperti është thirr në mbeturina, është i pambështetur meqenëse eksperti mendimin dhe konstatimin lidhur me përcaktimin e shumës e ka realizuar në bazë të faturave e nga të cilat konstatohet se malli i shitur është llamarinë e zinkuar (mbeturinë).

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64, të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lart, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, par 1 dhe 46 par. 1, 2, 3, 4, dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.417/22 datë 04.10.2024

Gj y q t a r j a,

Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.